



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë – Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, me bashkëpunëtoren profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NTP M... me seli ne – Viti, me Pronar E.A. , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Xhevdet Smakiqi me seli të zyrës në Prishtinë, kundër te paditurit KRM Pastrimi Sh.A. me seli në Prishtinë rr. Tahir Zajmi nr.5; të cilin e përfaqëson me autorizim Muhamet Veliu jurist në këtë kompani, për shkak të padisë për kompensim të demit, pas mbajtjes se seancës se datës 31.10.2022 për shqyrtim kryesor te çështjes, ne datën 7.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NE TERESI E PA BAZUAR padia e paditësit NTP M... me seli ne – Viti, me Pronar E.A. , me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura KRM Pastrimi / Autoriteti Kontraktues që paditësit t’ia paguaje demin e shkaktuar ne vlere 50’000.00 euro me kamate ligjore si për mjetet e deponuara mbi një vit, duke filluar nga data 01.07.2009 e deri e pagese përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në afat prej 7 ditësh.
- II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të shkaktuara në këtë procedure.

A r s y e t i m

I. Historiku i çështjes / pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e parashtruar gjykatës në datën 24.09.2009, ka kërkuar detyrimin e të paditurës KRM Pastrimi për kompensimin e demit në vlerë 50’000.00 euro, për shkak të diskualifikimit si tenderues për kontratën “Furnizim me kamion për bartjen e mbeturinave”. Kjo për shkak se paditësit i janë shkaktuar dëme me rastin e mos përzgjedhjes në tenderin e të paditurës, duke shkelur dispozitat e ligjit të Prokurimit, edhe pse eksperti i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kishte konstatuar se paditësja ka pasur lokacionin e përcaktuar për servisim dhe kishte dokumente relevante / marrëveshje mes tij si operator ekonomik dhe kompanisë A....në

Për kundërligjshmërinë në skualifikim të paditësit, i njëjti ka theksuar se ka qenë tenderuesi me i liri dhe me lokacion të përshtatshëm, ndërsa ankesa e tij në shkallë të dytë ndaj vendimit është refuzuar nga OSHP, me çka paditësi i është shkaktuar dëm për shpëputjen e marrëveshjes me Auto Servisnë, në vlerën 50’000.00 euro. Tutje ka theksuar se në këtë çështje ka pasur

edhe shkelje procedurale sepse paditësi nuk është njoftuar për dhënie apo mos dhënie të tenderit sepse njoftimi nuk është dhënë në mënyrë të rregullt, por përmes gazetës Kjo çështje – kjo mënyrë e njoftimit nuk përcaktohet sipas Ligjit të Prokurimit Publik. Nga këto veprime, është shkelur dispozita e nenit 52 të Ligjit për prokurimin publik (LPP) dhe të drejtat e ligjshme të paditësit si tenderues, pasi që në dosjen e tenderit i ka përmbushur kriteret dhe është eliminuar nga dhënia e kontratës edhe pse ka qenë ofertuesi me i lirë.

I njëjti gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor i ka kundërshtuar edhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare duke theksuar se një pjesë nga këto prova i ka paraqitur edhe ai vete me padi, ndërsa të tjerat i janë drejtuar organeve tjera dhe me këtë vërtetohet se e paditura i ka anashkaluar të drejtat ligjore të paditësit, duke mos ia dhënë tenderin edhe pse i kishte plotësuar kushtet e dosjes së tenderit, e duke shpërblyer një operator tjetër që ishte me i shtrenjtë me çmim me të lartë, me çka ia ka mohuar të drejtën ligjore, dhe e paditura ka bërë shkelje të LPP të Kosovës të atëhershëm në vitin 2009, 02L-99 neni 58 par.1., si dhe me këtë veprim i ka shkaktuar dëm paditësit në kuptim të dispozitave të LMD-se, neni 136 dhe neni 9.

Ne fjale përfundimtare ka theksuar se nga shqyrtimi gjyqësor u vërtetua se e paditura ka shkelur me vendimet e saja dispozitat e LPP - nenin 52, ku nuk e ka njoftuar në mënyrë të rregullt paditësin për procedurën e tenderit. Është vërtetuar gjithashtu se e paditura në mënyrë subjektive dhe kundërligjshëm ka mohuar përmbushjen e kriterëve të tenderit për servisimin e mjeteve motorike sepse paditësja i ka bashkangjitur autorizimet dhe marrëveshjet me palët e treta dhe *ex lege* dhe ka përmbushur kriterin për tu shpërblyer me kontrate nga e paditura në vlerën prej 327'000.00 euro. Poashtu u vërtetua se e paditura ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 58.1 të LPP 02L/99 kur e ka shpërblyer me kontratë operatorin tjetër me çmim me të lartë, duke anashkaluar e mohuar në mënyrë të njëanshme kriteret e aktivitetit të prokurimit të cilat vetë i kishte shpallur publikisht në gazetë.

Me veprimet e lartcekura ka theksuar se paditëses i është shkaktuar dëm në kuptim të dispozitave të LMD-së, andaj i kërkoi gjykatës që të aprovoje në tërësi kërkesëpadinë ashtu që të detyrohet e paditura KRM Pastrimi që paditëses t'ia paguaje dëmin e shkaktuar në vlerë 50'000.00 euro me kamate ligjore duke filluar prej datës 01.07.2009 e deri në pagese definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përfshirë edhe ato të përfaqësimit sipas Tarifës së Odës së Avokateve të Kosovës (TOAK) në afat prej 7 ditësh nën kërcenim të përmbarimit.

E paditura nga deklaratimet e bëra gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, si për nga baza ashtu edhe lartësia, duke shtuar se nga provat të cilat janë paraqitur me përgjigje në padi vërtetohet qartë se paditësi pa baze ka kërkuar kompensimin e dëmit. Sipas përgjigjes në padi, procedura e tenderimit është zhvilluar sipas Ligjit për Prokurimin Publik në bazë të se cilit është shpallur tenderi nga e paditura për "Furnizim me mjete motorike Lot 1 dhe Lot 2" i datës 06.07.2009, në të cilin kishin konkuruar 6 operatore ekonomik (OE).

Në këtë tender fitues ishte shpallur OE NTP M...Com i cili ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ultë dhe i njëjti është njoftuar për përzgjedhje me datë 17.07.2009. Në të njëjtën datë është njoftuar edhe paditësi për mos përzgjedhje për shkak se nuk e ka dorëzuar në dokumentacion marrëveshjen se ka servis të kontraktuar apo regjistruar dhe se nuk ka lokacion konkret të paraqitur për servisim të kamionëve. Ndaj njoftimit për mos përzgjedhje paditësi kishte parashtruar ankese tek OSHP për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPP-së, nenit 52 dhe 57, sipas të cilës OSHP, pastaj ka angazhuar ekspert për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit. Sipas raportit të ekspertit të paraqitur në datën 03.08.2009 konstatohet se paditësi OE NTP M... – nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të prokurimit dhe atë nenin 52, 57. 58.1 dhe 599.

Ky raport i ekspertit ishte kontestuar edhe me tutje, mirëpo duke mos i gjetur mbështetje, OSHP me vendimin e datës 21.08.2009 e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e të paditurës KRM Pastrimi për shpalljen e OE NTP M...Cem fitues të tenderit “Furnizim me mjete motorike Lot 1 dhe Lot 2” i datës 06.07.2009.

Në përmbledhje të kësaj – i padituri si në përgjigje në padi edhe në deklaratimet e dhëna në seancë gjyqësore pranë të cilave mbeti tërësisht, ka thënë se nuk është kontestuese se paditësi ka ofruar çmimin me të ultë tenderues, mirëpo sipas dispozitës ligjore të nenit 58 gjegjësisht paragrafi 1 theksohet se “Përveç siç thuhet në nenin 58.2 dhe 58.3, autoriteti kontraktues do të ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët.” sepse paditësi nuk ka plotësuar kushtet dhe kriteret fillestare në mënyrë që pastaj të futet në listën e OE për përzgjedhjen e tij.

Nga sa u tha me lartë, i padituri i propozoi gjykatës që të refuzohet kërkesëpapia e paditësit, të mbetet në fuqi vendimi nr. 1949/09 i datës 21 gusht 2009 i Panelit shqyrtues të prokurimit – OSHP, dhe të detyrohet paditësi për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore dhe shpenzimet tjera të të paditurit në afat prej 15 ditësh me kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. Administrimi i provave

Deklarimet e të autorizuarit të paditësit, deklaratimet e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Në kontestin e përgjithshëm të procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare për përcaktimin e rrethanave të kësaj çështje kontestuese, gjykata i është referuar provave të administruara si në vijim: 1. Vendimi i panelit shqyrtues të prokurimit nr. PSH.nr.1652/09 i dt. 20.08.2009; 2. Raporti mbi kryerjen e ekspertizës nga eksperti shqyrtues dt. 03.08.2009; 3. Vendimi i OSHP mbi pezullimin e aktivitetit PH 1643/09 dt. 18.03.2009; 4. Autorizimi i paditësit me dt. 21.05.2009; 5. Garancioni mes paditësit dhe të paditurit dt. 06.07.2009; 6. Autorizimi mes paditësit dhe F...dt. 21.05.2009; 7. Njoftimi i publikuar nga e paditura në gazetë Kosova Sot për aktivitetin e prokurimit dt. 17.07.2009; 8. Raporti i vlerësimit

06.07.2009; 9. Kontrata për punë dhe shërbime në mes të paditësit dhe autoservis– .., dt. 01.01.2009. 10. Njoftimi për shpalljen e tenderit lidhur me furnizimin me mjete motorike dt. 06.07.2009; 11. parashtresa me nr. prot. 1889/09 dt. 14.08.2009;

III. Vendimi i gjykatës

Gjykata, pas shqyrtimit të thënieve të lartcekura – padisë, përgjigjes në padi dhe parashtresave të palëve ndërgjyqëse si dhe provave të propozuara e të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, gjeti se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar në tërësi si e pabazuar, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsytet që elaborohen si në vijim të këtij arsytimi.

Paditësi NTP M... fillimisht kishte parashtruar padi kundër këtu të paditurës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit, por në seancën e datës 11.10.2022 hoqi dorë që kërkesëpadia të realizohet edhe ndaj të paditurës së dytë OSHP – të cilin gjykata e ka lejuar me aktvendim në seancën e po të njëjtës datë.

Nga shkresat e gjithmbarshme të lëndës konstatohet se pala e paditur ka hapur aktivitetin e prokurimit për “Furnizim me mjete motorike Lot 1 dhe Lot 2” i shpallur me date 06.07.2009, ne të cilin aktivitet të prokurimit kishte marr pjesë edhe paditësi.

Sipas vendimit përkatës të të paditurës, paditësi nuk është përzgjedhur fitues i aktivitetit të prokurimit të lartcekur, për çka edhe kishte parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Ky i fundit me vendimin e datës 21.08.2009 e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar për shkak të mos përmbushjes se kërkesës mbi mundësitë teknike dhe profesionale të kërkuara në dosjen e tenderit / Servisimi (të këtë servis të autorizuar për mjetet e kërkuara). Nga ky vendim gjykata konstaton se Paneli shqyrtues i prokurimit të OSHP-së kur ka trajtuar aplikacionin e dosjes së tenderit ka gjetur se paditësi NTP M... nuk ka aplikuar në tender si grup i operatoreve ekonomik me operatorin Golf – .., andaj ka dështuar të plotësojë kërkesat e specifikuar të tenderit të autoritetit kontraktues – këtu të paditurit KRM Pastrimi. Nga këto Paneli Shqyrtues i Prokurimit nuk i gjeti si të qëndrueshme pretendimet e paditësit të parashtruara në ankesën e tij bazuar në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, prandaj edhe e ka refuzuar ankesën e paditësit.

Meqenëse nga konstatimet e lartcekura, nuk u provua se e paditura i ka shkaktuar paditësit dëm me vendimin e saj për eliminimin nga procedura e aktivitetit të prokurimit, sipas dispozitave të përgjithshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk u provua lidhja kauzale e të paditurës nga çka do të lind detyrimi për kompensim të demit, andaj edhe e paditura KRM Pastrimit nuk mund të ngarkohet me detyrimin e kërkuar për kompensim.

Gjykata nuk e ka trajtuar vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit), sepse Departamenti për çështje ekonomike nuk ka tagër për vendosje të tillë, meqë kompetente është Departamenti për Çështje Administrative i kësaj Gjykate sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Nga sa u tha me larte, konform nenit 8 dhe nenit 143 të LPK-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi – pika I, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e bazoi në

nenin 450 të Ligjit për procedurën Kontestimore, meqë pala e paditur shpenzimet e saja të kërkuara nuk i ka specifikuar as për nga lloji, lartësia apo arsyeshmëria e kërkesës.

GJYKATA KOMERCIALE KOSOVËS
Dhoma e Shkalles I - Departamenti për Çështje Ekonomike
KE.nr.16/22, datë 7.11.2022

Gj y q t a r i,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të vendimit, Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkalles se dyte, përmes kësaj Gjykate.